

Syllabus i lëndës

Lënda: Letërsi shqipe

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 4 ECTS

Niveli dhe lloji i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 211

Fondi i orëve: 2+2

VITI AKADEMIK : 2015/2016

Semestri: -IV-

Mësimdhënësi: Prof. dr. Hysen Matoshi

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Në kuadër të përmbajtjes së lëndës *Letërsi shqipe* përfshihen vlerat kryesore letrare të kombit tonë, duke filluar që nga shkrimet e para në gjuhën shqipe e deri tek autorët më të njohur shqiptarë të së sotmes. Duke marrë parasysh faktin se bëhet fjalë për një proces zhvillimor letrar prej më se pesë shekujve, në kuadër të programit studimor janë përfshirë vetëm autorët dhe veprat, me të cilat identifikohen periudhat zhvillimore letrare shqiptare. Fillimisht janë marrë parasysh veprat letrare paragjuhësore – romantizmi dhe humanizmi shqiptar, dokumentet e para të shkrimit të shqipes, autorët e letërsisë së vjetër, alamiadaistët më të njohur shqiptar, përfaqësuesit e romantizmit arbëresh dhe të romantizmit shqiptar përgjithësisht, autorët e letërsisë pasromantike, përkatësisht të periudhës ndërmjet luftërave botërore dhe autorët më eminentë të letërsisë shqipe, të cilët i kanë shkruar veprat e tyre në periudhën nga Lufta e Dytë Botërore e këtej. Një vëmendje e posaçme iu kushtohet edhe njohjes dhe studimit të veçorive tematike, zhanrore e stilistike të veprave letrare, sikundër edhe formacioneve stilistike të letërsisë shqipe në një kontekst më përgjithësues.

Qëllimi i lëndës

Nëpërmjet lëndës Historia e letërsisë kombëtare studentët do t'i zgjerojnë njohuritë dhe so t'i thellojnë ato më mirë e më drejtpërdrejt, duke mësuar për veprat e ndryshme artistike të autorëve shqiptarë që nga fillimet e deri në ditët tona. Pra, ky kurs do t'iu ofrojë studentëve lëndë të bollshme nga fusha e letërsisë shqipe cilat do të reflektojnë edhe në njohuritë e përgjithshme të tyre.

Rezultatet e pritura të nxënies:

a). Studentët përmes analizave të veprave të autorëve të ndryshëm, të njohur për kontributin e

çmueshëm për letërsinë kombëtare, aftësohen për të interpretuar me të dhëna të qëndrueshme idetë, pikëpamjet, vlerat dhe rëndësinë gjuhësore, historike, edukative dhe artistike të veprave të krijuesve shqiptarë.

b). Studentët, përmes kursit, do t'i mësojnë t'i zërthejnë drejt e me kompetencë subjektet e veprave, me interes për ngjarje dhe fenomene të rëndësishme për historinë, gjuhën dhe traditën tonë.

c). Studentët, në sajë të leximit të autorëve dhe veprave më të arrira të letërsisë shqipe, zhvillojnë aftësitë e tyre shprehëse, si një komponent i rëndësishëm në profesionin e tyre të ardhshëm

Metodologjia e mësimdhënies:

Realizimi i lëndës së kursit do të zhvillohet nëpërmjet trajtimit të temave, motiveve, ngjarjeve me metoda adekuate, të cilat do të sigurojnë të dhëna relevante drejt analizave, shqyrtimeve, vështrimeve dhe konstatimeve tona përkitazi me strukturën e veprave dhe shestimet e autorëve të tyre.

Në këtë kontekst, si forma të punës në interpretimin e përmbajtjeve të veprave do të jenë ligjëratat e rregullta, punimet seminarike, ushtrimet, esetë, diskutimet, puna në grupe. Synohet qasja interaktive nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë:

Prezantimi i përmbajtjes së lëndës; Historia e letërsisë shqipe – kufijtë kohorë; aspekte të periodizimit në periudha zhvillimore historike letrare.

Java e dytë:

Kultura shqiptare në mesjetë dhe fillimet e shkrimit shqip (Dokumentet e para të shkrimit shqip) humanistët e parë shqiptarë (Marin Barleti: “Historia e Skënderbeut”)

Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 22-31.

Mr. Fadil Grajçevci, “Historia e Skënderbeut” e Marin Barletit dhe kultura shqiptare në shekullin XV, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1998

Java e tretë:

Letërsia e vjetër shqipe (Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi dhe Pjetër Bogdani)

Analizë: tekste të zgjedhura

Java e katërt:

Alamiadoja shqiptare – horizont i ri i letërsisë shqipe

Veçantitë letrare të autorëve të alamiados shqiptare

Muçi Zade “Imzot mos na lër pa kahve”

Nezim Berati, jeta dhe vepra letrare (shembuj)

Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 32-77.

Java e pestë:

Hasan Zyko Kamberi, poezia fetare dhe sociale e tij, mjetet shprehëse (shembuj)

Sylejman Naibi, tema e dashurisë

Muhamet Kyçyku – Çami “Errveheja” – vepra e parë tregimtare në letërsinë shqipe.

Ese – analizë letrare.

Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 32-77.

Java e gjashtë:

Letërsia arbëreshe e romantizmit

Jeronim de Rada, “Këngët e Milosaos” (pjesë të zgjedhura)

Gavril Dara i Riu,. “Kënga e sprasme e Balës”

Zef Serembe, lirika atdhetare

Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f. 232-285; 294-322.

Java e shtatë:

Letërsia shqipe në vitet 30-70 të shekullit XIX

Sami Frashëri, jeta dhe vepra e tij,

Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet (tekste të zgjedhura)

Kontributi i Samiut dhënë kulturës dhe dijes shqiptare

Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare f.; 133-148; 163-174.

Java e tetë:

Naim Frashëri – krijimtaria letrare dhe vlera e saj;

Naimi – poet kombëtar;

Arti dhe gjuha e Naimit

Analizë letrare

Literaturë: Rexhep Qosja, Histori e letërsisë shqipe – romantizmi III.

Java e nëntë:

Ndre Mjeda: Juvenila

Gjergj Fishta, jeta dhe vepra

Lahuta e Malcis (pjesë të zgjedhura)

Asdreni, poezia e tij

Literatura: Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 339-363.

Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, f. 283-304

Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, f. 418-440

Java e dhjetë:

Autorë të periudhës ndërmjet dy luftërave botërore:

- Noli, Albumi,

- Migjeni, vepra letrare

- Lasgushi, Ylli i Zemrës (Pjesë të zgjedhura)

Literatura: Historia e letërsisë shqiptare, f. 483-519; 521-530; 542-566.

Java e njëmbëdhjetë:

- Hafiz Ali Korça, jeta dhe vepra

- Poema Jusufi me Zelihanë (pjesë të zgjedhura)

- Shtatë ëndrrat e Shqipërisë dhe Vajtimet e Atdheut.

- Analizë e tekstit letrar.

Java e dymbëdhjetë:

Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore

Realizmi socialist si dogmë kufizuese

Kasëm Trebeshina, Promemoria

Jakov Xoxa, Lumi i vdekur

Java e trembëdhjetë:

Letërsia shqipe në ish-Jugosllavi

Esad Mekuli: Për ty

Adem Demaçi: Gjarpinjt e gjakut

Autorë të tjerë të letërsisë shqipe në ish-Jugosllavi

Java e katërbëdhjetë:

Dritëro Agolli

Lirika e Agollit (pjesë të zgjedhura)

Romanet e Agollit

Analizë e tekstit letrar

Java e pesëmbëdhjetë:

Ismail Kadare

Romanet me temë historike

Gjenerali i ushtrisë së vdekur

Kështjella

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura themelore- obliguese :

1. Grup autorësh, Historia e letërsisë shqiptare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK, Rilindja, Prishtinë, 1983.
2. Robert Elsi, Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë, 1997
3. Mr. Fadil Grajçevci, “Historia e Skënderbeut” e Marin Barletit dhe kultura shqiptare në shekullin XV, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1998.
4. Rexhep Qosja, Histori e letërsisë shqipe – romantizmi I, II, III, Rilindja, Prishtinë, 1984-1986.

Literatura opcionale:

1. Velek, R. Voren O., Teoria e letërsisë, Prishtinë.
2. Hysen Matoshi, Stilet në letërsinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore, Instituti

Albanologjik, Prishtinë, 2008.

3. Rexhep Qosja, Porosia e Madhe, Rilindja, Prishtinë, 1986.